



Pranuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivery	28-07-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	4376/2022		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.538/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.538/2022 të datës 16.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 27.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.538/2022 e datës 16.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me datë 16.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3536/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për harmonizim të koeficientit me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.06.2022 ka proceduar



kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 24.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 3536/2022 të datës 16.06.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimin e datës 15.10.2012 në emër të ankuesit; Zarin e datës 14.06.2022; Plotësimin e ankesës së datës 30.06.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 29.11.2018 në emër të ankuesit; Vendimin me Nr. 01/112/02-0090419-2/18 i datës 29.11.2018 për transferim të përhershëm të ankuesit; Listën e pagave për ankuesin për muajin prill, maj 2022; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës të Sektorit të Zhvillimit Rural të datës 21.09.2012; Konkursin e Brendshëm i datës 08.05.2019 për Udhëheqës të Sektorit të Tatimit në Provë të shpallur nga Komuna e Mitrovicës së Jugut; Konkursin e datës 21.02.2022 për Udhëheqës të Sektorit të Administratës dhe Financave të shpallur nga Komuna e Mitrovicës së Jugut; Konkursin e datës 20.05.2021 për Udhëheqës të Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të shpallur nga Komuna e Istogut; Konkursin e datës 01.11.2021 për Udhëheqës të Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të shpallur nga Komuna e Podujevës; Zarin e datës 28.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 22.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 24.06.2022; Kërkesën për transferim e datës 26.11.2018 nga ankuesi; Plotësimin e ankesës e datës 15.07.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 13.07.2022 nga Menaxheri i Personelit për ankuesin; Kërkesë për ngritje të koeficientit e datës 09.06.2022 nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut; Përgjigjen plotësuese e datës 26.07.2022; Akt Emërimin e datës 08.12.2013 për Drejtor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm; Akt Emërimin e datës 15.04.2014 për Koordinator për kthim të Qëndrueshëm; Akt Emërimin e datës 23.04.2013 për Koordinator për të drejtat e komuniteteve dhe integrim; Akt Emërimin e datës 09.12.2013 për Shef i Zyrës së Prokurimit; Akt Emërimin e datës 23.04.2013 për Udhëheqës i Njesisë për të Drejtat e Njeriut; Akt Emërimin e datës 27.08.2013 për Koordinator i Gjendjes Civile; Akt Emërimin e datës 22.01.2013 për Shef i Sektorit të Punëve të Përbashkëta; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 02.09.2019 për Udhëheqës i Sektorit për Shërbime me Qytetarë; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 28.12.2016 për Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Rrugore; Akt Emërimin e datës 01.08.2012 për Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike; Akt Emërimin e datës 14.08.2013 për Shef i Sektorit të Kadastrit; Akt Emërimin e datës 14.08.2013 për Shef të Sektorit të Gjeodezisë; Akt Emërimin e datës 24.10.2013 për Shef të Sektorit të Arsimit; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 30.07.2013 për Udhëheqës i Sektorit për Punë Financiare, Juridiko-Administrative dhe Mjekësore; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 06.10.2015 për Udhëheqës i Sektorit të Legalizimit; Akt Emërimi i datës 18.11.2013 për Shef të Sektorit të Planifikimit; Akt Emërimin e datës 05.12.2013 për Shef të Sektorit të Urbanizmit; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 08.07.2019 për Drejtor të Qendrës për Punë Sociale; Akt Emërimi i datës 26.11.2013 për Shef të Sektorit për Çështje Sociale; Akt Emërimi i datës 08.11.2013 për Shef të Sektorit të Bujqësisë; Akt Emërimin e datës 03.08.2012 për Shef të Sektorit të Shërbimeve Komunale; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 18.06.2018 për Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit; Akt Emërimin e datës 04.01.2012 për Shef të Sektorit për Pylltari; Akt Emërimin e datës 14.01.2012 për Shef të Sektorit të Inspeksionit të Tregut; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 30.09.2013 për Shef i Zyrës Ligjore; Akt Emërimi i datës 23.04.2013 për Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit Komunal; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 19.04.2018 për Menaxher Personelit; Akt Emërimi i datës 20.08.2012 për Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Hutim; Akt Emërimi i datës 05.04.2022 për Udhëheqës i Sektorit të Administratës



dhe Financa; Akt Emërimi i datës 15.03.2016 për Udhëheqës i Njesisë së Komunikimit Publik; Akt Emërimi i datës 31.10.2019 për Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë; Akt Emërimi i datës 02.10.2014 për Zyrar Kryesor Financiar; Akt Emërimi i datës 01.05.2012 për Shef të Sektorit për Buxhet dhe Financa.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Akt Emërimit të datës 15.10.2012 rrjedhë së ankuesi ka qenë i punësuar në pozitën *Shef i Sektorit për Zhvillim Rural*, në Komunën e Mitrovicës me koeficient 7.5 të pagës. I njëjti me datë 26.11.2018, parashtron kërkesë për transferim në një pozitë ekuivalente, ndërsa me Vendimin me Nr. 01/112/02-0090419-2/18 të datës 29.11.2018 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershme nga pozita Shef i Sektorit për Zhvillim Rural në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit Rural, duke ju lëshuar ndryshim dhe plotësimi i Aktit të emërimit me numër protokollit 01-112/02-0090956/18 të datës 29.11.2018, po me koeficient 7.5 të pagës.

Ankuesi më datë 09.06.2022 ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut për harmonizimin e koeficientit, ndërsa më datë 13.07.2022 në përgjigje të kërkesës së ankueses Menaxheri i Personelit, ka njoftuar anësuesin se koeficienti i pagës për udhëheqësit e Sektorëve është përcaktuar bazuar në katalogun e vendeve të punës sipas të cilit kjo pozitë ka pasur koeficient 7.5 të pagës apo gradën 7, ndërsa pozita e udhëheqësit të sektorit në pronë është me koeficient 8.5 pasi që shpallja është bërë përmes SIMBNJ-së dhe vet sistemi ka përcaktuar gradën dhe koeficientin.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e datës 13.07.2022 të Udhëheqësit të Personelit, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin së në Komunën e Mitrovicës së Jugut nuk ka nivelizim të pagave për pozita të njëjta, pasi që disa shefa të sektorëve kanë koeficient 8.5, disa koeficient 9 dhe 9.5 të pagës, çka kemi jo barazi të punësuarve në këtë institucion. Propozon që Këshilli të miratojë kërkesën për ngritje të koeficientit të pagës ashtu siç e kanë udhëheqësit e sektorëve të tjera brenda Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj së e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së organi i punësimit respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka unifikim të pagës për udhëheqësit e sektorëve pasi aplikohen koeficient të ndryshëm lidhur me këto pozita të kategorisë së njëjtë, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se Udhëheqësi i Sektorit për Buxhet dhe Financa ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit Për Financa dhe Zhvillim Ekonomik ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Tatimit në Pronë ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësja e Zyrës për Informim ka koeficient





9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Administratash dhe Financave ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Komunitete dhe Kthim ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Sekretarisë së Kuvendit ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Personelit ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit Ligjor ka koeficient 9.5, ndërsa udhëheqësit e sektorëve të tjerë duke përfshirë edhe ankuesin si Udhëheqës i Sektorit të Projekteve të Zhvillimit Rural kanë koeficient 7.5 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte dhe konstatime, Kolegji vlerëson së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *“Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve të së njëjtës kategori brenda të njëjtit institucioni është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.*

Nisur nga fakti së ankuesi ka qenë i emëruar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.05/2012 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht sipas nenit 14 të kësaj Rregullore pozita udhëheqës i sektorit përcaktohej si pozitë e nivelit drejtues një (1) me grada shtatë (7) të pagës, duke u evidentuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës (i miratuar me datë 05.02.2015 i ndryshuar dhe plotësuar me 21.08.2018), me EZHE/420 dhe gradë 7 të pagës.

Po ashtu bazuar në nenin 34 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 05/2012 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore kanë qenë të detyruar që të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitave në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimi dhe vendosjes lidhur me këtë çështje, mori parasysh shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 10.11.2014 të lëshuar nga drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP, për Sekretarët e Përgjithshëm, drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe menaxherët e personelit të institucioneve publike përmes së cilës shkresë janë vendosur koeficientet e pozitave përkatëse rrjedhimisht për pozitën udhëheqës i sektorit është vendosur koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si me lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut me rastin e mos harmonizimit të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë, kështu që Kolegji vlerëson së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.*

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit



Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.538/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Bekteshi*  
Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

